



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
NJËSIA E PROKURIMIT

Nr. _____ Prot.

Data __. __. 2025

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Mallra ushqimore për kopshtin me drekë”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Ushqim për fëmijë – 15884000-8; Përzierje ushqimesh – 15893100-5; Ushqime për shkollë - 15894210-6

VLERA E FONDIT LIMIT: 1 333 333 (një milion e treqind e tridhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë e tre) lekë pa tvsh

Argumentimi i fondit limit: Komisioni i llogaritjes fondit limit dhe specifikimeve teknike për llogaritjen e fondit limit i është referuar nenit 76 të pikës (b) të VKM-së me nr.285, datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për rregullat e prokurimit publik” i ndryshuar, që përcakton “studimin e tregut, bazuar në mesataren e çmimeve të marra nga ky studim”, çmimet i ka bazuar te studimi i tregut bazuar kjo në mesataren e çmimeve të marra nga studimi që ka kryer komisioni i llogaritjes së fondit limit dhe specifikimeve teknike (KLLFLST). Nga ofertat e marra nga subjektet që operojnë në aktivitete të ngjashme me objektin e këtij prokurimi, komisioni ka vendosur çmimet në bazë të mesatares së ofertave, me qëllim që vlera limit e kontratës, të jetë një vlerë reale për kushtet e tregut dhe njëkohësisht e të krijojë mundësinë e pjesëmarrjes së sa më shumë operatorëve ekonomikë. (Dokumentuar me relacionin shpjegues të KLLFLST nr. 335/2 prot datë 27.01.2025).

Në bazë të nenit 21 pika 2 të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, nenit 2 pika 2/c dhe nenit 78 pika 2 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Roskovec ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;

Argumentimi: Pika 1a Kërkesa për Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit bazohet në nenin 82 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Neni 26 i VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Pika 1.b Kërkesa e mësipërme për sigurimin e ofertës mbështetet në Ligjin Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar neni 83 pika 1 si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Kreu V, Seksioni II, Neni 30 pika 1.

Këto kritere janë vendosur për të vertetuar pjesëmarrjen ose jo të operatorit ekonomik në tendera, duke paraqitur oferte. Gjithashtu këto kritere janë vendosur edhe për të vërtetuar deklaratimet dhe dokumentat e paraqitura nga operatorët ekonomik, duke kaluar tërësisht përgjegjesinë administrative ose penale gjithashtu barrën e proves tek operatorët ekonomik për dokumentat e paraqitura.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:

Plotësimi i kapaciteteve ligjore nga operatorët ekonomikë dhe vërtetimi se ata kanë zotësi juridike për të lidhur kontrata prokurimi, bëhet me anë të paraqitjes prej tyre të deklaratës mbi përmbushjen e kritereve të përgjithshme, sipas shtojcës 7 dhe 8.

- Objekti i veprimtarisë së operatorit ekonomik sipas ekstraktit të QKB-se duhet i ngjashëm me objektin e kesaj procedure.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 14 pika 2 dhe 77 pika 1/a dhe 2 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar; nenin 39 pika 6/b dhe nenin 88 pika 4 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Ky kriter vendoset për të vërtetuar që operatori ekonomik pjesëmarrës ka eksperiencën e duhur dhe kapacitetin potencial ekonomik.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2021, 2022 dhe 2023, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së perlologaritur të kontratës, **perkatesisht 533 333 lekë pa tvsh.**

Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse operatorët ekonomik arrijnë vlerën e xhiros minimale në të paktën 1 (një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77 pika 3 e Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar si dhe nenin 43 pika 4 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vendorsja e ketij kriteri kualifikues i sherben Autoritetit Kontraktor per te vertetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron te gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare per te permbushur me sukses kontraten.

2.2.2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore për vitet financiare 2021, 2022, 2023 të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve ne perputhje me Ligjin nr.10091 date 05.03.2009 "Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit te ekspertit kontabel te regjistruar dhe te kontabilistit te miratuar" i ndryshuar, Kreu V, neni 41, pika c.

Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 3 e Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, si dhe ne nenin 43 pika 4 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës konkretisht, Ligjit nr. 10091 date 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar” i ndryshuar. Autoriteti Kontraktor mund të kërkojë nga OE pjesëmarrës në një procedurë prokurimi të japin informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare, që të tregojë raportet nëpërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, Ligjit nr. 8438 datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 5 datë 30.01.2006 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar nenit 29 të ligjit nr. 8438 datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore” i ndryshuar: *“Çdo tatim-pagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatim-paguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në Udhëzimin e Ministrit të Financave, në zbatim të këtij ligji”.*

2.2.3 Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2024 ne zbatim të Ligjit Nr.9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar. (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB).

Ky kriter përmbushet nepermjet paraqitjes se Formularit permbledhes te Vetedeklarimit sipas shtojces 8 ne DST.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar sipas nenit 76 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar; Kreut V, Seksioni III, Nenin 43 pika 6 të VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar si dhe sipas Ligjit Nr.

9632 datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Vendorsja e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar që operatorët ekonomikë nuk kanë pagesa të pashlyera të taksave dhe tarifave vendore.

2.3 Kapaciteti teknik:

Për të provuar përvojën e mëparshme operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi dëshmi për furnizime të ngjashme të kryera gjatë tre viteve të fundit ku vlera e kërkuar duhet të jetë jo më e madhe se 20% e vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës perkatesisht: **266 667 leke pa TVSH.**

2.3.1 Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik ose fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Për kontratat e realizuar si Bashkim Operatorësh, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontratën e bashkimit të operatoreve të deklaruara në fazën e tenderimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe në nenin 55 pika 4/b të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 20% të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë: Përvoja e mëparshme është element shumë i nevojshëm që garantojnë autoritetin, se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës shërbimeve të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie. Në mbështetje të nenit 88 pika 1, 3 e VKM 285/2021 i ndryshuar, parashikon se “Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve. AK argumenton se furnizimet e mëparshme të ngjashme është kërkesë, e cila shërben për të vlerësuar përvojën e duhur të Ofertuesve. Vlerësimi i përvojës realizohet duke paraqitur dokumentat e kërkuara sipas pikave (pika a dhe b të cilat vërtetojnë eksperiencën në realizimin e shërbimeve publike/private

të ngjashme, si dhe janë një garanci më shumë për Autoritetin Kontraktor me qëllim përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi.

2.4 Operatori ekonomik duhet të vërtetojë se e zhvillon aktivitetin e tij në fushën objekt prokurimi në përputhje me standardet e menaxhimit të cilësisë, të sigurse ushqimore.

Për këtë duhet të paraqesë certifikatat e mëposhtme:

- ISO 9001:2015 (Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë) ose ekuivalente.
- ISO 22000:2018 (Sistemit të Menaxhimit të Sigurisë Ushqimore) ose ekuivalente

Certifikatat të jenë të lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomik, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë certifikata ISO sipas zërave të mallrave që do të marrë përsipër të realizojë.

Argumentim: Kërkesat e cilësisë të përcaktuara sipas nenit 79 pika 1 e ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar citohet se: *“Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”* si dhe në zbatim të nenit 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku përcaktohet se: *“Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”*.

Autoriteti Kontraktor gjykon se kërkesa për pajisjen e Ofertuesve me Çertifikatat e kërkuara është brenda kuadrit të parashikuar nga legjislacioni për prokurimin publik. Çertifikata e kërkuara janë në përputhje me objektin e kontratës dhe respektojnë natyrën e mallrave.

ISO 9001:2015 është kërkuar me qëllim vërtetimin e efektivitetit dhe efektshmërinë në zhvillimin e veprimtarisë së operatorit ekonomik, e cila do të sjellë dhe zvogëlimin e kostove, duke bërë të mundur që ofertuesit të ofrojnë cilësi të mirë me çmime të ulta.

ISO 22000:2018 është kërkuar me qëllim marrjen e masave parandaluese për sigurinë e ushqimit, duke ndihmuar në identifikimin, parandalimin dhe zvogëlimin e rreziqeve në zinxhirin ushqimor nga ferma në tavolinë.

2.5 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të jete i pajisur me liçence lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit me kategorite e mëposhtme:

II.1.A.-Prodhim perpunim,shperndarje me shumice e ushqimeve per njerez.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Per prokurimin publik” i ndryshuar në të cilin përcaktohet se: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; 2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë. Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t’u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.”

2.6 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë vetdeklarimin sipas shtojcës 9 të DST, Formulari Përmbledhës i Vetdeklarimit, ku të deklarojë se disponon mjet transporti ATV frigoriferik për furnizimin e Çerdhes sipas grafikut të levrimit të mallrave, në pronësi ose në përdorim, në momentin e deklarimit si dhe përgjatë gjithë periudhës së zbatimit të kontratës **NESE SELIA E OPERATORIT EKONOMIK SIPAS EKSTRAKTIT TË OKB- SË NUK ËSHTË BRENDA TERRITORIT TË QYTETIT ROSKOVEC**, dhe Operatori ekonomik i klasifikuar i pari, **përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit**, duhet të paraqes dokumentacionin që disponon mjetin e transportit ATV frigoriferik, të vertetuar me:

- leje qarkullimi,
- çertifikate pronësie
- siguracion (TPL)
- çertifikatë e kontrollit teknik

Përveç dokumentave të sipërpërmendura, në rastin e qeras: të paraqitet kontrata e marrjes me qera të mjetit shoqëruar me dokumentacionin përkatës të pronësisë së mjetit që ka pronari, i cili e jep me qira.

Ndërsa në rastin kur Operatori ekonomik pjesëmarrës **NDODHET ME SELI BRENDA TERRITORIT TË QYTETIT TË ROSKOVECIT** mjafton të disponoj një mjet në pronësi ose me qera për furnizimin e Kopshtit sipas grafikut të levrimit të mallrave dhe për këtë të paraqesë dëshmi për mjetin që ka në dispozicion apo mund të vihen në dispozicion, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës:

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë mjetet dhe pajisjet që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Ndërsa Operatori ekonomik i klasifikuar i pari, **përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit**, duhet të paraqes dokumentacionin që disponon mjetin e transportit si më poshtë:

- a) Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), policen e sigurimit, çertifikatën e kontrollit teknik, taksat vjetore të mjetit.
- b) Në rastin e qerasë: të paraqitet kontrata e marrjes me qera të mjetit shoqëruar me dokumentacionin përkatës të pronësisë së mjetit që ka pronari, i cili e jep me qira.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 40, pika 5/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për

miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Autoriteti Kontraktor është në të drejtën e tij për të kërkuar që operatori ekonomik ofertues të disponojë një automjet për transportin e mallrave objekt kontrate.

2.7 Operatori Ekonomik duhet të deklarojë se merr përsipër furnizimin e mallrave të Kopshtit sipas grafikut të levrimit të mallrave bashkëngjitur preventivit shtojca 5 e DST-së.

Argumentimi: Autoriteti Kontraktor është në të drejtën e tij të bazuar në legjislacionin e prokurimit publik dhe akteve nënligjorë të nxjerra në zbatim të tij, për të kërkuar deklarata për përmbushjen me sukses të kontratave.

2.8 Referuar pikës 1, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku parashikohet : *“Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”*, si dhe përcaktimet e pikës 6 të këtij neniku parashikohet: Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 26 pika 1 e VKM-së, nr.285 datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar .

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

U ra dakort nga antaret e Njesisë së Prokurimit të ngritur me urdher të titullarit të autoritetit kontraktor **nr. 14 date 29.01.2025**, për këto kërkesa për kualifikim pasi kërkesat e mësipërme janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës që është: **“Mallra ushqimore për kopshtin me drekë”** me fond limit prej: **1 333 333 (nje milion e treqind e tridhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë e tre) lekë pa tvsh**, lloji i procedurës: **E hapur e thjeshtuar**.

Ato do të shërbejnë për njohjen e plotë të gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.

Kërkesat e veçanta të kualifikimit të mësipërme përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me LPP i ndryshuar dhe VKM nr.285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të

prokurimit publik” i ndryshuar. Kriteret e hartuara janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Për secilin kriter janë përcaktuar dokumentet konkretë që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e atyre kriterëve.

SPECIFIKIMEVE TEKNIKE:

I. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike janë hartuar nga grupi i posaçëm i cili është ngritur me Urdher të Titullarit për llogaritjen e fondit limit dhe hartimin e specifikimeve të teknike në përputhje me nenin 4 pika 38/b dhe nenit 36, të ligjitnr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”i ndryshuar, si dhe nenit 40 pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Specifikimet teknike shprehin tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe në përputhje të plotë me funksionet e kërkuara nga Autoriteti.

Specifikimet teknike gjenden në shtojcën 6 të Dokumentave Standarte të Tenderit. - Bashkëlidhur DST Në SPE.

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, nëpërputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36,të LPP i ndryshuar, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr.285 datë19.05.2021,“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar**, ku çdo reference duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.*

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet oseshërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas nenit 36 pika 3 e LPP i ndryshuar. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët“ose ekuivalente”.

Argumentim Sp.teknike: Anëtarët pranuan specifikimet teknike të hartuara nga Komisioni i posaçëm: **KLLFLST (Komisioni i llogaritjes të fondit limit dhe specifikimeve teknike)** i ngritur me Urdhër të titullarit të Autoritetit Kontraktr **nr. 335 prot datë 17.01.2025**, duke

konsideruar se ato shprehin qartë kërkesat e autoritetit kontraktor për mallrat që do të blejë. Preventivi është hartuar nga specialistet e fushës konkretisht nga KLLFLST, dorëzuar dokumentacioni teknik si preventivi me **procesverbalin e komisionit nr. 335/1prot datë 27.01.2025** si dhe **specifikimet teknike nr. 335/3 prot date 27.01.2025** te cilat shprehin qarte kërkesat e autoritetit kontraktor për cilësinë e të gjitha mallrave.

Preventivi i hartuara nga KLLFLST si më poshtë për objektin”

**Objekti:"Mallra ushqimore për kopështin me drekë"
BASHKIA ROSKOVEC**

N r	Emërtimi	Njësia	Sasia
1	Bukë Thekre Integrale	Kg	1400
2	Qumesht i Fresket Lope	Lt	1750
3	Kos	Lt	222
4	Mish Vici	Kg	220
5	Mish Pule	Kg	130
6	Gjize Lope pa kripe	Kg	168
7	Veze	Kokerr	6000
8	Recel Kumbulle	Kg	45
9	Miell Gruri/Niseshte	Kg	120
10	Tershere	Kg	45
11	Trahana	Kg	45
12	Thjerza	Kg	90
13	Fasule	Kg	103
14	Sheqer	Kg	80
15	Miell Misri	Kg	50
16	Oriz	Kg	120
17	Makarona	Kg	90
18	Vaj Ulliri	Lt	150
19	Vaj Lule dielli	Lt	50
20	Djath	Kg	45
21	Patate	Kg	310
22	Qepe e thate	Kg	80
23	Karrota	Kg	190
24	Domate	Kg	190
25	Kastravec	Kg	97
26	Salce	Kg	45
27	Bizele	Kg	95
28	Banane	Kg	250
29	Fruta Te Stines(Molle,Portokalle,Qershi,Kajsi)	Kg	1250

30	Zaravate(Kungull,Laker,Spinaq)	Kg	265
31	Kripe	Kg	20
32	Limon	Kg	34
33	Rigon	Kg	5
34	Fryres Keku	Kg	4
35	Majdanos	Tufe	400
36	Kartopoceta	Pako	500

Afatet e lëvrimet: Fillon nga data e lidhjes së kontratës dhe mbaron deri më **12 (dymbëdhjetë) muaj.**

Dokumentacioni pasi u firmos nga të tre anëtarët e Njesisë së Prokurimit, pasi u përpilua edhe formulari përmbledhës i njoftimit të kontratës, do të paraqitet titullarit të autoritetit kontraktor për tu firmosur dhe u ra dakort që të hidhen në formatin e sistemit elektronik nga personi përgjegjës i prokurimeve anëtar i NJ.P, për shpallje dhe botim nga APP.

NJËSIA E PROKURIMIT: